

Komisioni per rihapjen e çështjeve penale
Informacion për ju që kërkon rihapjen e një çështjeje penale.

Vlerësim objektiv

Komisioni për rihapjen e çështjeve është një organ i pamvarur, që vendos nëse një i dënim nga një gjykim me vendim të prerë (pa të drejtë ankese) duhet të rishqyrtohet apo jo. Pas marrjes së një vlerësimi objektiv, komisioni, duhet të vendosë nëse kushtet për rihapjen e çështjes plotësohen. Komisioni vendos vetë mënyrën e punës dhe nuk mund të intsruktohet (udhëzohet).

Kushtet për rihapje

Arsyet më të rëndësishme që një gjykim i një çështjeje penale me vendim të prerë të rishqyrtohet ne gjyq, janë:

- Prova ose rrethana të reja që mund të çojnë deri në lirim ose në dhënjën e një dënimi substancialisht (shumë) më të ulët.
- Nëse një gjykatë ndërkombëtare ka konstatuar që vendimi ose shqyrtimi i çështjes bie në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, me rrjedhojë që një rishqyrtim i mundshëm i çështjes rezulton në një vendim tjetër nga ai ekzistues.
- Në rast se dikush që ka pasur të bëjë në një mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen në fjalë, ka pranuar fajin duke mos qenë fajtor në një vepër penale që mund të ketë pasur domethënie (rëndësi) në marrjen e vendimit
- Kur ka raste të veçanta që paraqesin dyshime nëse gjykimi është i drejtë, dhe arsye të rëndësishme kërkojnë që çështja të hapet përsëri.

Udhëzim aktiv dhe kërkim

Lutja për rihapje duhet të dorëzohet me shkrim në formularët e përcaktuar. Nuk ka asnjë afat. Komisioni ka për detyrë të udhëzojë ata që kërkojnë rihapjen e çështjes së tyre. Komisioni ka vetë përgjegjësi që të gjitha informacionet relevante në çështje të dalin në dritë. Prandaj nuk është e nevojshme ndihma e një avokati ose hetuesi privat.

Zakonisht komisioni kontakton vete individin, kjo nqse personi ne fjalë nuk është i përfaqësuar nga një avokat. Vetëm në rast arsyesh të veçanta i caktohet një avokat personit që kërkon rihapje të çështjes.

Analizim i plotë

Komisioni i rihapjes ka përgjegjësi që të ndërmerret një analizim i plotë gjyqësor si edhe shqyrtim i anës faktike të çështjes, si dhe mund të marrë informacione në atë mënyrë që mund të konsiderohet e përshtatshme. Komisioni mund të thërrasë të gjykuar dhe dëshmitarë, duke përfshirë edhe të dëmtuarit, për të marrë në pyetje, mund të japë urdhër për ekstradim dhe të emërojë ekspertët. Komisioni ka një sekretariat të vetin me analistë që ndihmojnë në shqyrtimin e çështjeve. Raporti i të demtuarit në çështje.

Nëse kërkesa për rihapje të çështjes nuk refuzohet nga komisioni, por i nënshtrohet një vlerësimi më të hollësishëm, atëherë duhet që i dëmtuari ose të afërmit e lëne pas të informohen që kërkesa për rihapje është pranuar. I dëmtuari ose të afërmit e lëne pas kanë të drejtën per njohjen e përmbajtjes së dokumentave të çështjes penale, po ashtu kanë të drejtë të japin një deklaratë me shkrim. Ata kanë gjithashtu të drejtë të bëjnë kërkesë për ti dhënë shpjegim komisionit, dhe zakonisht kanë të drejtë për shikimin e informacioneve qe komisioni ka mbledhur gjatë kërimit/analizimit të tij.

Vendimi i komisionit

Kryetari i komisionit mundet ti refuzojë kërkesat qe sipas mendimit të tij nuk mund të rihapen, si dhe, nëse është e dukshme që shqyrtimi i kërkesës nuk mund të ketë rezultat. Për çështje të tjera mund të vendosë komisioni. Nëse komisioni arrin ne perfundim që kushtet për rihapje plotësohen, atëherë kërkesa merret parasysht dhe çështja hapet përsëri.

Ligji mbi procedurën e gjyqit të çështjeve penale § 397

§ 397. Komisioni ka për detyrë të udhezojë atë që kërkon rihapjen e çështjes, në mënyrë që personit në fjalë ti ruhet interesi vetjak sa më mirë që të jetë e mundur. Komisioni duhet që me iniciativë të veten të vlerësojë nëse i dënuari ka nevojë për udhëzim apo jo. Komisioni mund t'i caktojë të dënuarit një avokat rodeo (publik) kur e kerkojnë raste të vecanta. Rregullat në §§ 101-107 janë të ngjashme në këtë rast. Komisioni mund ti caktojë avokat mbrojtës të pandehurit në përputhje me rregullat në §§ 107 a-107 d. Vendimet e komisionit sipas § 78 neni i dytë për pagën e avokatit mbrojtës dhe/ose avokatit për çështje të posacme (krime seksuale, thyerje e ndalimit të kontaktit, ndalim vizitash) janë përfundimtare.

Nëse kërkesa është një vendim i tillë që nuk mund të rihapet, ose nuk përmban asnjë arsye që sipas ligjit mund të cojnë në rihapje të saj, atëherë komisioni mund të refuzojë kërkesën pa i bërë ndonjë shqyrtim të hollësishëm duke iu përmbajtur rregullores mbi vendimet gjyqësore.

E njëjta gjë vlen edhe për rastet kur duket qartë që kërkesa për arsye të tjera nuk mund të cojë në ndryshim vendimi. Vendimi mund të merret nga kryetari ose zv.kryetari i komisionit. Kur nuk ka dyshime mbi një vendim të dhënë, sic është përshkruar më sipër, atëherë është e mundur ti përmbahesh kësaj pa pasur nevojë për të paraqitur arsye të tjera.

Nqse kërkesa nuk rrefuzohet duke u bazuar në dispozitat e nenit të tretë, atëherë vendimi i bëhet i ditur edhe palës tjetër (palës së dëmtuar). Në qoftë se kontrolli i përkohshëm (nëse verehet që vendimi i marrë bie në kundërshtim me ligjin), është i bazuar në informacione të tjera, ndryshe nga këto që janë të paraqitura në kërkesë, atëherë duhet që këto informacione ti parashtrohen palëve, për deklaratën që jepet para marrjes së vendimit. Këtu nuk bëhet fjalë për informacione të cilat i pandehuri nuk ka të drejtë ti dijë sipas §264, ose informacion që vjen nga pala tjetër.

Komisioni informon për sa i përket kërkesës, të dëmtuarin dhe të afërmit sipas rradhës të rregulluar me ligj, me përjashtim kur ajo rrefuzohet sipas nenit të tretë. I demtuarin dhe të afërmit e lënë pas duhet të informohen sipas rradhës të rregulluar me ligj (afërsia familjare) rreth të drejtës për njohjen e përmbajtjes së dokumentave, të japin deklaratat dhe të bëjnë kërkesë për ti dhënë shpjegim komisionit, përfshirë këtu edhe mundësinë për t'iu caktuar avokat te posacëm.

Antarët dhe sekretariati i komisionit

Antarët e komisionit	Analistët e komisionit
Antarët e komisionit emërohen nga Mbreti në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, dhe komisioni ka pesë antarë dhe tre zv. antarë. Kryetari, zv.kryetari dhe një nga antarët duhet të kenë Gradë Akademike në Shkencat Juridike. Kryetari emërohet për një periudhë 7-vjecare pa mundësi për zgjatje. Antarët emërohen për një periudhë 3-vjecare, me vetëm një mundësi për riemërim. Antarët kanë së bashku shumë përvojë në fushat e mëposhtme si :gjykata, organet e ndjekjes penale, organet e mbrojtjes, shkenca dhe jeta shoqerore etj..	Përveç kryetarit, komisioni ka një sekretariat me dhjetë punonjësa, ku tetë nga këto janë analistë dhe dy janë nëpunës. Gjashtë prej analistëve janë juristë dhe dy kanë përvojë ose shkollim nga policia.

Informacion kontaktimi (adresa dhe nr e telefonit)

Adresa postare: Postboks 2097 Vika, 0125 Oslo	Faks: 22 40 44 01
Adresa e vizitave: Tordenskioldsgate 6	Email: post@gjenopptakelse.no
Telefon: 22 40 44 00	Faqja ne internet: www.gjenopptakelse.no

Nqse ju keni pyetje persa i perket kushtet per rihapjen dhe/ose per shqyrtimin e ceshtjes , ju lutemi kontaktoni me komisionin.